



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR

KËSHILLI BASHKIAK

Ballsh më, 29.04.2025

PROCESVERBAL

I mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak Mallakastër. Kryesues i mbledhjes është Z. Nexhmi Sulaj. Ora e mbledhjes: 14:00. Kryesuesi i mbledhjes deklaroi kuorumin prej 11 anëtarësh. Të pranishëm nga administrata: Z. Aleksandër Ramaj, zj. Kleidja Hoxhaj.

Kryetari i Këshillit e hap mbledhjen me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 26.03.2025.
3. **Projektvendim Nr. 15:** Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.
4. **Projektvendim Nr. 13:** Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Mallakastër me objekt “Përmirësimin e infrastrukturës asfaltike në segmentin rrugor Aranitas-Metoh, Bashkia Mallakastër, L=5860” dhe miratimin në parim për shpronësimin/zhdëmtimin e pronarëve që mund të preken nga zbatimi i këtij projekti.
5. **Projektvendim Nr. 14:** Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Mallakastër me objekt “Ndërtimi i rrugës Cfir – Kufiri me Bashkinë Berat L = 1548 Bashkia Mallakastër” dhe miratimin në parim për shpronësimin/zhdëmtimin e pronarëve që mund të preken nga zbatimi i këtij projekti.

Të gjitha janë sipas njoftimit që keni marr, por janë dhe dy projektvendime shtesë që janë shpërndarë sot.

- **Projektvendim Nr. 16:** Për një ndryshim të Vendimit Nr. 56, datë 20.12.2021 “Për kategorizimin e niveleve të përfaqësimit të nxënësve në olimpiadat rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare, në maturën shtetërore, çmime të tjera dhe përcaktimin e masës së shpërblimit të tyre”.

- **Projektvendim Nr. 17:** “Për miratimin e marrëveshjes së investimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Mallakastër me objekt “Përmirësimi i transportit lokal dhe urban me ndërhyrje në ura dhe nyje lidhëse, ura Lumarë, Bashkia Mallakastër”.

Le të marrim një sqarim për këto dy projektvendime dhe nëse jeni dakord, ose votohet me 2/3 e votave të hyjnë në rend dite.

Votohet që këto materiale të mos hyjnë më mbledhje e kësaj radhe me 11 vota kundër.

Kalojmë me votimin për rendin e ditës.

Votojnë 11 pro, asnjë kundër. Miratohet.

Kalojmë te pika 2, lexohen vendimet e mujait mars.

Kalojmë me pikën 3: Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.- këtë periudhës nuk ka ndryshim me listë, prandaj besoj se jeni dakord.

Z. Adrian Hazizaj: Po rekomandime të tjera ska?

Zj. Kleidja Hoxhaj: Jo, s'ka pasur, nëse do këtë ne i marrim parasysh dhe e themi çfarë dokumentash duhet plotësuar.

Hidhet në votim. Votojnë 11 pro, asnjë kundër. Miratohet.

Kalojmë me pikën 4: Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Mallakstër me objekt "Përmirësimin e infrastrukturës asfaltike në segmentin rrugor Aranitas-Metoh, Bashkia Mallakastër, L=5860" dhe miratimin në parim për shpronësimin/zhdëmtimin e pronarëve që mund të preken nga zbatimi i këtij projekti.

Z. Qerim Ismailaj: Kjo është një marrëveshje si çdo marrëveshje tjetër që kemi bërë, për pallatet, për rrugën e Bylisit, etj. Kjo është një ndihmë për bashkinë, mqs nuk i ka të gjitha mundësit për kryerjen e këtyre investimeve.

E njëjta gjë është dhe projektvendimi tjetër: Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Mallakstër me objekt "Ndërtimi i rrugës Cfir – Kufiri me Bashkinë Berat L = 1548 Bashkia Mallakastër" dhe miratimin në parim për shpronësimin/zhdëmtimin e pronarëve që mund të preken nga zbatimi i këtij projekti, që lidhet rreth 4.5 km me Bashkinë Mallakastër, por kjo është rrugë e bardhë. Të mos kemi keqkuptime.

Z. Klodian Shehaj: Në mbledhjen e komisionit juridik kërkojmë një përgjegjës nga zyra juridike dhe të marrëveshja thotë që duhet konsultim publik.

Z. Qerim Ismailaj: quhet e kryer dëgjesa, që në ato që bëhen për buxhetin, sepse janë si zëra të buxhetit, dhe ne bëjmë marrëveshje me FSHZH çdo projekt të cilin ne e përshkruajmë në buxhet.

Hidhet në votim, votojnë 11 pro, asnjë kundër. Miratohet.

Kalojmë për pikën 5: Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Mallakstër me objekt "Ndërtimi i rrugës Cfir – Kufiri me Bashkinë Berat L = 1548 Bashkia Mallakastër" dhe miratimin në parim për shpronësimin/zhdëmtimin e pronarëve që mund të preken nga zbatimi i këtij projekti, e cila u përmend më lart.

Hidhet në votim, më qënë se kryetari e sqaroi: votojnë 11 pro, asnjë kundër. Miratohet.

Faleminderit për prezencën!

MBAJTËS I PROCESVERBALIT
SEKRETARI I KËSHILLIT
Zinaida Ahmetaj